

## Pistoletë e 28 fishekë në valixhen e pasagjerit të një autobusi në Merdar



Foto: Ilustrim

Policia e Kosovës ka njoftuar se gjatë kontrollimit të një autobusi me targa vendore në Merdar, në valixhen e një pasagjeri kanë gjetur dhe sekuestruar një pistoletë dhe 28 fishekë.

13 mars 2024, 09:11

## Shpërndaje në



Rasti është iniciuar si "import, eksport, furnizim, transportim, prodhim, këmbim ose shitje e paautorizuar e armëve apo materieve plasëse".

Rasti ka ndodhur mëngjesin e së mërkurës.

“Zyrtarët policorë kufitarë së bashku me zyrtarët doganorë, gjatë kontrollimit të një autobusi me targa RKS, në valixhen e një pasagjeri mashkull kosovar kanë gjetur dhe sekuestruar një pistoletë të kalibrit 9-mm, dhe 28 fishekë”, thuhet në raportin e Policisë.

Në konsultim me prokurorin thuhet se rasti shkon në procedurë të rregullt.

© KOHA. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara.



**Klikoni këtu nëse dëshironi t'i lexoni lajmet e fundit  
dhe të përzgjedhura në kanalën tonë zyrtar në Viber**

#MERDAR

Taboola Feed



## Njësia ruse pro-Ukrainës futet në Rusi, dalin pamje në kufi

## Kohane




## Gjuriqi reagon pasi iu publikua fotografia me Radoiçiqin: S'do t'iu kërkoj falje Kurtit e Sveçlës

## Kohane


TË TJERA



**Humb jetën një burrë në  
Leposaviq pas kontaktit me  
rrymën**



## Një i vdekur e dy të lënduar nga aksidenti në Vushtrri



## Aksident në Klinë, një i vdekur e tre të lënduar



Dyshohet për dhunimin e një 13-vjeçareje, ndalohen për 48 orë dy të dyshuar